



Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh dhe Stafitë UPT-së në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + për vitin 2018 në Universitetin e Barit, Itali

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 biletarale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës në Universitetin e Barit në Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të doktoraturës
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- *Doktoraturë* (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Doktorature në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave:

- Doktorantë (3muaj) – numri total i studentëve PhD : 2 student
- Doktorantë (4muaj) – numri total i studentëve PhD : 2 student
- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie- numri total i stafit për mësimdhënie: 2 staf 5 dite secili

Fushat e studimit:

Arkitekture/Urbanistike

Dokumentat e nevojshme për aplikim per studentët e Doktoraturës:

- Formulari i aplikimit CV+Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (në gjuhën angleze i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik);
- Diplomë Master;
- Listë notash të masterit (të përkthyer në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Italisht/Anglisht);
- Letra konfirmuese nga profesori pritës i Universitetit të Barit



- Plani i aktivitetit shkencor të doktorantit dhe periudha e mobilitetit në Universitetin pritës, miratuar nga udhëheqësi shkencor në UPT, dhe përgjegjësi i njësisë bazë, përgjegjës për programin e studimit;

Afati i aplikimit deti ne Daten 09.03.2018

Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie për stafin akademik:

- Formulari i aplikimit
- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Një letër motivimi(në gjuhën angleze)
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve.
- Certifikata e gjuhës së huaj(Niveli minimal i gjuhës angleze B2)
- Vërtetim pune;
- Aprovim nga Përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për tu kryer në Universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga Universiteti pritës;
- Dokumenti i Mobility Agreement (“Staff Mobility for Teaching” or Staff Mobility for Training”) për stafin akademik në Universitetin pritës;

Afati i aplikimit deti ne Daten 16.03.2018

Për të shkarkuar formatin e “Mobility Agreement”klikoni si më poshtë:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf